

**KOMBET E  
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen  
Penale të Personave Përgjegjës për  
Shkelje të Rënda të së Drejtës  
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera  
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej  
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-PT

Data: 24 shkurt 2011

Originali: anglisht

**NË DHOMËN GJYQËSORE II**

**Para:** Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës  
Gjykatësit Burton Hall  
Gjykatësit Guy Delvoie

**Sekretari:** Z. John Hocking

**Vendim:** 24 shkurt 2011

**PROKURORI**

**kundër**

**RAMUSH HARADINAJT  
IDRIZ BALAJT  
LAHI BRAHIMAJT**

***PUBLIK***

**VENDIM MBI KËRKESËN E IDRIZ BALAJT BAZUAR NË PARAGRAFIN B TË  
RREGULLËS 73 PËR TË LEJUAR APELIMIN E VENDIMIT TË DHOMËS  
GJYQËSORE TË 8 SHKURTIT 2011**

**Zyrës së Prokurorit:**

Z. Paul Rogers

**Avokatëve të Mbrojtjes:**

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn  
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn  
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

**KJO DHOMË GJYQËSORE** e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Kërkesë e Idriz Balajt Bazuar në Paragrafin (B) të Rregullës 73, për të Lejuar Apelimin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 8 shkurtit 2011”, dorëzuar më 15 shkurt 2011 (“Mocion”) dhe jep më poshtë vendimin përkatës.

## **I. HISTORIA PROCEDURALE**

1. Më 19 korrik 2010, Dhoma e Apelit shfuqizoi vendimin e Dhomës Gjyqësore për dhënien e pafajësisë Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt për disa pika të Aktakuzës dhe urdhëroi rigjykim për këto pika<sup>1</sup>. Më 15 shtator 2010 Dhoma Gjyqësore urdhëroi që Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt të jetë aktakuza në fuqi gjatë rigjykimit të pjesshëm.<sup>2</sup> Më 9 nëntor 2010, Prokuroria dorëzoi versionet “e shënuara” dhe “të pastra” të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt që korrespondojnë me lëndën e rigjykimit të pjesshëm. (“Aktakuza e Shkurtuar”).<sup>3</sup>

2. Më 14 janar 2011, Dhoma Gjyqësore lëshoi “Vendim mbi Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt” (“Vendim mbi Aktakuzën”), në të cilin urdhëroi korrigjime në Aktakuzën e Shkurtuar.<sup>4</sup>

3. Më 18 janar 2011, Haradinaj dorëzoi “Kërkesë në Emër të Ramush Haradinajt për Leje për Apelim bazuar në paragrafin (B) të Rregullës 73 (“Mocion i Haradinajt për Leje për Apelim”) ku ndër të tjera kërkohet që në lidhje me urdhrin në Vendimin mbi Aktakuzën, paragrafi 24 i Aktakuzës së Shkurtuar të zëvendësohet me paragrafin 26 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt (“Vendim i Apeluar prej Haradinajt”).<sup>5</sup> Më 3 shkurt 2011 Dhoma Gjyqësori lëshoi “Vendim mbi Kërkesën në Emër të Ramush Haradinajt për Leje për Apelim bazuar në paragrafin (B) të Rregullës 73 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Vendim mbi Lejen për Apelim për Haradinajn”) me anë të të cilit u lejua apelimi.

<sup>1</sup> Prokurori k. Haradinajt, Balajt dhe Brahimajt, Lënda Nr. IT-04-84-A, Aktgjykim, 19 korrik 2010 (“Aktgjykimi i Apelit”), para 377.

<sup>2</sup> Urdhër lidhur me Aktakuzën në Fuqi dhe Vetëdeklarimet, 15 shtator 2010

<sup>3</sup> Parashtrim i Versionit të Ri të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 9 nëntor 2010, Shtojcat A dhe B.

<sup>4</sup> Vendimi mbi Aktakuzën, para. 42.

<sup>5</sup> Mocion i Haradinajt për Leje për Apelim, para 3, 4.

4. Më 21 janar Prokuroria dorëzoi “Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar (“Parashtrim”) që përmbante versione “të shënuara” dhe “të pastra” të Aktakuzës së Shkurtuar të rishikuar (“Aktakuzë e Shkurtuar e Rishikuar”),<sup>6</sup> në përputhje me Vendimin mbi Aktakuzën;
5. Më 26 janar 2011 Balaj dorëzoi “Kërkesë e Idriz Balajt për Sqarim të Vendimit të 14 janarit 2011 në Lidhje me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar dhe për Urdhër Drejtuar Prokurorisë Për Ndryshimin e Versionit të Ri të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar” (“Mocion i Balajt për Sqarim”).
6. Më 8 shkurt 2011 Dhoma Gjyqësore lëshoi “Vendim mbi Kërkesën e Idriz Balajt për Sqarim të Vendimit të 14 janarit 2011 në Lidhje me Paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar” (“Vendim i Apeluar”), me anë të të cilit rrëzoi Mocionin e Balajt për Sqarim.
7. Më 15 shkurt 2011 Brahimaj dorëzoi “Kërkesë e Lahi Brahimajt për Bashkim me Kërkesën e Idriz Balajt Bazuar në paragrafin (B) të Rregullës 73 të Rregullores për të Lejuar Apelimin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore të 8 shkurtit 2011” (“Kërkesë për Bashkim”) me anë të së cilës ai bashkohet me argumentet dhe burimet e cituara në Mocion.
8. Më 18 shkurt 2011 Prokuroria bëri të ditur se nuk synonte të paraqiste Përgjigje.<sup>7</sup>

## **II. PARASHTRIME TË PALËVE**

9. Balaj kërkon leje për të apeluar rrëzimin prej Dhomës Gjyqësore të kërkesës për sqarim të Vendimit mbi Aktakuzën dhe kërkesës për Urdhër Drejtuar Prokurorisë Për Ndryshimin e Versionit të Ri të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar.<sup>8</sup>
10. Balaj parashton se paragrafi 24 i Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar e ballafaqon me rrezikun që ai të riprocedohet penalisht për krime për të cilat është shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë<sup>9</sup> dhe se sqarimi i natyrës dhe kuadrit të pretendimeve dhe/ose akuzave në Aktakuzë është vendimtar për një rigjykim të pjesshëm të drejtë dhe të shpejtë si

<sup>6</sup>Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt të Rishikuar, 21 janar 2011, Shtojcat A dhe B

<sup>7</sup> Letërkëmbim elektronik i 18 shkurtit 2011.

<sup>8</sup> Mocion, para 1, 13-15.

<sup>9</sup> *Po aty.*, para. 23.

dhe për të drejtën e tij për njoftim të duhur mbi akuzat e saktësuara në lidhje me të cilat ai duhet të përgatitet për rigjykim të pjesshëm.<sup>10</sup> Ai gjithashtu parashtron se një përgjigje e menjëhershme në lidhje me sqarimin e kësaj çështjeje prej Dhomës së Apelit ndihmon thelbësisht procesin.<sup>11</sup>

11. Në Kërkesën për Bashkim Brahimaj parashtron se interesave të drejtësisë do tu shërbehet më së miri duke e lejuar atë t'u bashkohet argumenteve dhe burimeve të cituara në Mocion.<sup>12</sup>

### III. LIGJI PËRKATËS

12. Në bazë të paragrafit (B) të Rregullës 73, “vendimet në lidhje me të gjitha mocionet nuk i nënshtrohen apelit të ndërkohshëm, me përjashtim të rastit kur Dhoma Gjyqësore ka miratuar leje, e cila mund të japë një leje të tillë nëqoftëse vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte në mënyrë të dukshme kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjyqimit dhe për të cilën, sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, një vendim i menjëhershëm nga ana e Dhomës së Apelit mund ta ndihmojë thelbësisht procesin”.

13. Paragrafi (B) i Rregullës 73 e përjashton lejen, me përjashtim të rasteve kur Dhoma Gjyqësore konkludon se përmbushen të dy kushtet e tij, dhe edhe sikur të përmbushen të dy kushtet e paragrafit (B) të Rregullës 73, leja është përsëri në kompetencën gjyqësore të Dhomës Gjyqësore.<sup>13</sup> Leja bazuar në paragrafin (B) të Rregullës 73 nuk ka të bëjë me faktin nëse vendimi është arsyetua korrektësisht ose jokorrektesisht.<sup>14</sup>

### IV. DISKUTIM

14. Vendimi i Apeluar në lidhje me paragrafin 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar prek një aspekt që ndikon thelbësisht aktakuzën kundër Balajt. Në secilën prej pikave të

<sup>10</sup> *Po aty.*, para. 24.

<sup>11</sup> *Po aty.*, para. 30.

<sup>12</sup> Kërkesë për Bashkim, para. 15.

<sup>13</sup> *Shih* për shembull *Prokurori k. Strugarit*, Lënda Nr. IT-01-42-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Leje, 17 qershor 2004, para. 4; *Millutinoviq dhe të tjerë.*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Ndërkohshëm të Vendimit të Rregullës 98 bis, 14 qershor 2007 (“Vendim i 14 qershorit 2007”), para 4. *Shih edhe* Vendim mbi Kërkesën e Milletiqit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj Pranimit të Deklaratës si Ekspert të Gjeneralit Rupert Smith, 15 prill 2008 (“Vendim i 15 prillit 2008”)

<sup>14</sup> *Shih* për shembull *Prokurori k. Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Leje për Apelimin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore mbi Mocionin e Prokurorisë për Procedimin Voir Dire, 20 qershor 2005, para 4; Vendim i 15 prillit 2008, f. 4; Vendim i 14 qershorit 2007, para. 4

Aktakuzës pretendohet se Balaj kreu krime brenda kuadrit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale (“NPK”) dhe se rishikimi i paragrafit 24 kërkuar nga Balaj, do të ndryshonte thelbësisht kuadrin e NPK-së. Dhoma Gjyqësore konkludon se çështja e miratimit ose mosmiratimit të ndryshimit të kërkuar nga Balaj, do të ndikonte thelbësisht në kryerjen e një procesi të drejtë dhe të shpejtë dhe në rezultatin e procesit.

15. Megjithëse Mocioni dhe Mocioni i Haradinajt për Leje për Apelim efektivisht kërkojnë të njëjtën gjë për fjalinë e dytë dhe të tretë të paragrafit 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar, ndryshimi midis dy kërkesave ka lidhje me fjalinë e parë të paragrafit 24, që pretendohet se përkufizon qëllimin e përbashkët kriminal.<sup>15</sup> Rrëzimi i Mocionit do ta pengonte Balajn të argumentonte se kuadri i NPK-së duhet të jetë thelbësisht i ndryshëm nga ai kërkuar prej Haradinajt. Dhoma Gjyqësore konkludon se rëndësia e rrëzimit të kërkesës së Balajt për korrigjim të paragrafit 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar është e një natyre të tillë që një vendim i menjëhershëm nga ana e Dhomës së Apelit mund ta ndihmojë thelbësisht procesin.

16. Rrjedhimisht, janë përmbushur kriteret për leje përcaktuar në paragrafin (B) të Rregullës 73 lidhur me problemet ngritur nga Balaj.

## V. VENDIM

17. Për arsyet e lartpërmendura, bazuar në paragrafin (B) të Rregullës 73, Dhoma Gjyqësore:

- (1) **LEJON** Brahimajn që t’u bashkohet argumenteve dhe burimeve të cituara në Mocion; dhe
- (2) **MIRATON** Mocionin dhe **URDHËRON** që të miratohet leje në lidhje me apelim të rrëzimit prej Dhomës Gjyqësore të kërkesave për sqarim të Vendimit mbi Aktakuzën dhe për Urdhër të Prokurorinë për redaktimin e pjesëve të përcaktuara të paragrafit 24 të Aktakuzës së Shkurtuar të Rishikuar

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

<sup>15</sup> Mocion, para. 14, Mocion i Haradinajt për Leje për Apelim, para. 3.

/nënshkruar në origjinal/  
Gjykatës Patrick Robinson  
Kryegjykatës

Sot, më datën 24 shkurt 2011.  
Në Hagë  
Holandë

**[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]**